STELLA MARE SH.P.K.
Pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

Raporti i Audituesit të Pavarur i

Pasqyra e pozicionit financiar 1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse 2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital 3
Pasqyra e flukseve monetare 4

1. Informacion i përgjithshëm 5
2. Baza e përgatitjes 5
3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël 5
4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara 12
5. Standarde dhe interpretime të reja 14
6. Aktive të trupëzuara 14
7. Aktive me të drejta përdorimi 14
8. Aktive të patrupëzuara 15
9. Llogari të arkëtueshme 15
10. Aktive të tjera 16
11. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre 16
12. Kapitali aksionar 16
13. Llogari të pagueshme 16
14. Detyrime të tjera 17
15. Detyrime qiraje 17
16. Të ardhura nga shërbimi 18
17. Kosto e shërbimeve 18
18. Shpenzime personeli 18
19. Shpenzime të përgjithshme dhe administrative 19
20. Tatimi mbi fitimin 19
21. Menaxhimi i rrezikut financiar 20
22. Angazhime dhe pasiguri 24
23. Transaksione me palët e lidhura 24
24. Ngjarje pas periudhës raportuese 25
25. Politika kontabël për qiratë përpara 1 janar 2019 25

STELLA MARE SH.P.K.

(Të gjitha shumat janë në Lek '000, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktivet			
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	2,959	1,605
Aktive me të drejtë përdorimi	7	9,882	-
Aktive afatgjata jomateriale	8	876	1,168
Totali i aktiveve afatgjata		13,717	2,773
Aktivet afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme	9	99,742	188,127
Aktive të tjera	10	11,207	11,943
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	11	56,351	38,307
Totali i aktiveve afatshkurtra		167,300	238,377
Totali i aktiveve		181,017	241,150
Kapitali			
Kapitali i paguar	12	13,670	13,670
Fitime të mbartura		52,669	43,038
Totali i kapitalit		66,339	56,708
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	13	90,019	169,077
Detyrime të tjera	14	14,792	15,365
Detyrimi i qirasë	15	3,509	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		108,320	184,442
Detyrimet afatgjata			
Detyrimi i qirasë		6,358	-
Totali i detyrimeve		114,678	184,442
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		181,017	241,150

Pasqyrat financiare janë miratuar dhe firmosur nga Drejtimi i Stella Mare SH.P.K. më 19/06/2020

Dejan Nikolic
Drejtor i Përgjithshëm

Juventila Teqja
Drejtore e Përgjithshme Financiare

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shërbimet	16	208,196	180,802
Shpenzime të transportit dhe energjisë elektrike	17	(103,124)	(84,314)
Shpenzime personeli	18	(22,407)	(21,239)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	6,7,8	(4,850)	(870)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	19	(15,369)	(22,461)
Fitimi para tatimit		62,446	51,918
Tatimi mbi fitimin	20	(9,809)	(8,668)
Fitimi neto për vitin		52,637	43,250
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		52,637	43,250

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

	Kapitali i paguar	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2017	27,314	78,764	106,078
Fitimi i vitit	-	43,250	43,250
Zvogëlim i kapitalit	(13,644)	-	(13,644)
Dividend i paguar	-	(78,736)	(78,736)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	13,670	43,278	56,948
Fitimi i vitit		52,641	52,641
Dividend i paguar	-	(43,250)	(43,250)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	13,670	52,669	66,339

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e flukseve monetare

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		62,446	51,918
Rregullime për:			
Amortizimi	6,7,8	4,850	870
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:		67,296	52,788
Ulje/(rritje) në llogaritë e arkëtueshme	8	88,385	(29,584)
Ulje në aktivet e tjera	9	736	14,366
(Ulje)/rritje në llogaritë e pagueshme	13	(79,058)	44,055
Ulje në detyrime të tjera	14	(573)	(107)
Flukset neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		76,786	81,518
Tatim fitimi i paguar		(9,202)	(8,668)
Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit		67,584	72,850
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve të trupëzuara	6	(1,726)	389
Blerje e aktiveve të patrupëzuara	7	(292)	(1,163)
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese		(2,018)	(774)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese			
Dividend i paguar		(43,250)	(78,736)
Zvogëlim i kapitalit dhe rezervave		-	(13,644)
Pagesat e qirasë	15	(4,272)	-
Flukset neto të përdorura në veprimtaritë financuese		(47,522)	(92,380)
Rritja e e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre		18,044	(20,304)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës		38,307	58,611
Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019	10	56,351	38,307

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Stella Mare SH.P.K. ("Shoqëria") u themelua në Shqipëri si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 2 nëntor 2016. Adresa kryesore e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Qemal Stafa, Pazari i Ri, Nr.74, kulla 1, kati i dytë.

Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqerisë është të shërbejë si agjenci për transportin detar. Shoqëria ka si numër identifikimi unik ("NIPT") L62309016P.

Stella Mare SH.P.K operon si agjent ("Agjenti") i Maersk Line A/S, në Danimarkë ("Linja"), me qëllim për të promovuar dhe shitur shërbimet e linjës në territorin e Shqipërisë dhe të mbajë dhe/ose të koordinojë çdo aktivitet, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në aktivitete portuale, të nevojshme për eficencën dhe performancën e duhur të Linjës.

Shoqëria është në bashkëpronësi të Balfin sh.p.k (50%) dhe Milsped Doo Beograd (50%). Më 31 dhjetor 2019 numri i punonjësve të Shoqërsië është 14 (31 dhjetor 2018: 14 punonjës).

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), në bazë të parimit të kostos historike. Përveç ndryshimeve të politikave kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 16 në fuqi nga 1 janari 2019, këto politika janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, nëse nuk specifikohet ndryshe (referojuni shënimit 4). Politikat bazë kontabël të zbatuara për qiratë financiare deri më 31 dhjetor 2018 paraqiten në shënimin 25.

Pasqyrat financiare janë shprehur në lekë dhe vlerat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt ('000), përveçse kur është shprehur ndryshe.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël

Polikat bazë kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë kryhen në Lek ("Lek"), e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku Shoqëria ushtron aktivitetin e saj.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar kursin e këmbimit në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë:

Monedha	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

(b) Instrumentat financiarë

Zhvlerësimi i aktiveve financiare – provizioni për humbjen e pritshme të kredisë ("HPK").-Në korrik 2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), publikoi versionin final të SNRF 9- Instrumentat Financiare, i cili zëvendësoi SNK 39- Instrumentat Financiare: Njohja dhe matja si dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 përmbledh të treja aspektet e projektit të kontabilizimit të instrumentave financiarë: klasifikimi dhe matja, zhvlerësimi dhe kontabiliteti mbrojtës. SNRF 9 është efektiv për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar 2018, ku aplikimi i më hershëm është i lejuar. Me përjashtim të kontabilitetit mbrojtës, aplikimi në periudhat e mëparshme është i kërkuar, por informacioni krahasues nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat përgjithësisht kërkojnë aplikim në periudhat në vijim, më një numër të përcaktuar përjashtimesh.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentat financiarë (vazhdim)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 Shoqëria ka trajtuar për herë të parë analizën e klientëve të pa arkëtuar sipas kushteve të kreditimit. Për këtë Shoqëria ka përllogaritur provizion në pasqyrat financiare në bazë të rrezikut të arkëtimit të klientëve.

Shoqëria zbaton metodën e thjeshtuar të SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritshme të kredisë që përdor një humbje të pritshme për të gjitha të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera. Për të matur humbjet e pritshme të kredisë, të arkëtueshmet tregtare janë grupuar në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe ditëve në vonesë. Normat e pritshme të humbjeve bazohen në profilet e pagesave të shitjeve gjatë një periudhe kohore dhe humbjet historike përkatëse të kreditit që kanë ndodhur brenda kësaj periudhe.

Matja e HPK është një vlerësim i rëndësishëm që përfshin metodologjinë e përcaktimit, modelet dhe inputet e të dhënave. Shoqëria vlerëson në mënyrë individuale të gjitha llogaritë e arkëtueshme për më shumë se 365 ditë. Humbja e pritshme e kredisë është produkt i ekspozimit në momentin e dështimit, humbjes së parazgjedhur dhe probabilitetit të mospagimit.

Të gjitha llogaritë e tjera tregtare vlerësohen kolektivisht duke përdorur një qasje të thjeshtuar në HPK gjatë jetëgjatësisë së tyre. Raportet e humbjeve sipas kategorive llogariten bazuar në matricën e provizioneve që e konsideron ekspozimin me vonesë, normat e vonesës historike, dërgesën e klientit dhe ndryshimet në kushtet e pagesës së klientit.

Shoqëria nuk ka bërë rregullime të normave të zhvlerësimit historike me parashikimet e indikatoreve makroekonomikë pasi vlerësimi i lidhjes reciproke mes arkëtimeve dhe këtyre indikatorëve është i pamundur me të dhënat e publikuara.

Shoqëria, për shkak të llojeve të kufizuara të instrumentave financiarë, nuk pret ndryshime në klasifikimin e instrumentave financiarë (p.sh. llogari të arkëtueshme).

Shoqëria fillimisht i njeh të arkëtueshmet dhe mjetet monetare në datën kur janë krijuar. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë aktivet e caktuara në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht ne ditën e tregtimit, në të cilën Shoqëria behet palë në provizionin kontraktual të instrumentit. Shoqëria e çregjistron një aktiv financiar kur e drejta e përfitimit të flukseve të parasë të gjeneruara nga aktivi skadon, ose kur transferon të drejtën e përfitimit të flukseve të parasë të gjeneruara nga aktivi në një transaksion, në të cilin shumica e rreziqeve dhe e përfitimeve që lidhen me të transferohen. Çdo interes që krijohet ose mbahet nga Shoqëria gjatë tranferimit të aktivit financiar njihet si një aktiv ose pasiv i veçantë.

Një pasiv financiar çregjistrohet kur detyrimi ndaj këtij pasivi perfundon, eleminohet ose skadon. Kur një pasiv financiar ekzistues zëvëndësohet nga një tjetër nga i njejti huadhënës në kushte të ndryshme, ose kur kushtet e detyrimit ekzistues ndryshojnë shumë, ky lloj këmbimi ose ndryshimi trajtohet si një çregjistrim i pasivit fillestar dhe njohje e pasivit të ri. Ndryshimi në vlerën kontabël njihet në pasqyrën e të fitimit ose humbjes.

Aktivet dhe pasivet financiarë kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur palët kanë të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe kanë për qëllim shlyrjen në baza neto ose njohjen e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Instrumentat financiare jo-derivativë të Shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë gjendjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parave, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara me maturitet fillestar deri në tre muaj, të percaktuara si më sipër, e netuar me llogaritë e zbuluara bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga rënia në vlerë.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga rënia në vlerë.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(c) Aktivet e trupëzuara

Njohja dhe matja

Aktivet e trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka.

Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur, gjithashtu dhe kostot e huamarrjes të kapitalizuara. Kostot mund të përfshijnë dhe transferta nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të fitimeve ose humbjeve nga mbrojtjet të fluksit të mjeteve monetarë të kualifikueshme për blerjen e akiveve të trupëzuara. Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Kur pjesët e një elementi të aktiveve afagjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si njësi (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale. Humbjet apo fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimi e një elementi të aktiveve afagjata materiale, përcaktohen nga krahasimi i të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale dhe njihen neto nën grupin e "Të ardhurave të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Nëse është e mundur që përfitimet ekonomike që i atribuohen një elementi të aktiveve të trupëzuara do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e aktiveve të zëvendësuara çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të trupëzuara njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kosto e nje aktivi, ose cdo vlerë tjetër që zëvëndëson koston, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke përdorur normat e amortizimit si më poshtë. Kjo reflekton kryesisht mënyrën e pritur të konsumit të përfitimeve ekonomike të pritshme që janë pjesë e aktivit. Aktivet në proces nuk amortizohen.

	Në %
Pajisje zyre	20%
Pajisje kompjuterike	25%

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve të trupëzuara rivlerësohen në fund të çdo periudhe raportuese.

(d) Aktivet me të drejtë përdorimi

Shoqëria merr me qira ndërtesa dhe automjete. Kontratat mund të përmbajnë komponentë qiraje dhe jo-qiraje Shoqëria e ndan vlerësimin në kontratë për komponentët e qirasë dhe jo-qirasë bazuar në çmimet e tyre të pavarura relative. Aktivet që rrjedhin nga qiraja fillimisht maten në bazë të vlerës aktuale.Aktivet me të drejtë përdorimi maten me kosto që përfshin elementët e mëposhtëm:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë e kryer në ose para datës së fillimit të qirasë, pa përfshirë çdo incentivë të përfituar,
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për kthimin e aktivit në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

Aktivet me të drejtë përdorimi në përgjithësi amortizohen gjatë jetës së dobishme më të shkurtër mes aktivit dhe afatit të qirasë, në bazë lineare. Nëse Shoqëria është e sigurt se do te ushtrojë një mundësi blerjeje, aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet për jetën e dobishme të aktiveve kryesore. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi që lidhen me ndërtesat dhe automjetet llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë afatit të qirasë.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(e) Aktivet e patrupëzuara

Njohja dhe matja

Aktivet e patrupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka.

Kostot vijuese

Kostot vijuese njihen me vlerën kontabël të aktivit të patrupëzuar vetëm nëse rritin përfitimet ekonomike në të ardhmen dhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha kostot e tjera, duke përfshirë Emrin e Mirë, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e aktivit, ose çdo vlerë tjetër zëvendësuese për koston, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një normë amortizimi vjetore prej 25%.

(f) Çvlerësimi

Aktivet financiare

Aktivet financiare vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënien në vlerë. Aktivet financiare konsiderohen të çvlerësuara nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit kanë pasur një ndikim në rrjedhën e pritshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga rënia në vlerë e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare që janë të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe reflektohen në një llogari zbritje ndaj të arkëtueshmeve. Kur nje ngjarje vijuese shkakton një zbritje në humbjen e rënies në vlerë, ulja në humbjen nga rënia në vlerë anullohet nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Aktivet jo-financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për rëniet e vlerës. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet rënia në vlerë. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohen flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimin para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen ne pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(g) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqërore dhe pensionet

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse të të ardhurave (fitim ose humbje) kur ndodhin.

Lejet vjetore të paguara

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

(h) Provizionet

Provizionet për detyrimet janë detyrime jo financiare me kohë ose shuma të pasigurta. Ato janë përllogaritur kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Rezervat maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohet për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

(i) Detyrime të qirasë

Detyrimet për qiranë maten në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse monetare. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale të pagesave te mëposhtme:

- pagesa fikse (përfshirë pagesa fikse thelbësore), të pakësuara nga çdo stimul qiraje të marrë,
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit
- shumat e pritshme për t'u paguar nga Shoqëria sipas vlerës së mbetur të garancive,
- çmimi i ushtrimit të opsionit të blerjes nëse Shoqëria është e sigurt për ushtrimin e këtij opsioni., dhe
- pagesat e penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse Shoqëria mendon ta ushtrojë këtë opsion.

Mundësitë e shtyrjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të konsiderueshëm të qirave për aktivet e Shoqërisë. Këto kushte përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në menaxhimin e aktiveve që Shoqëria përdor për operacionet e saj. Pjesa më e madhe e opsioneve të shtyrjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga ana e Shoqërisë dhe jo nga qiradhënësi. Opsionet e shtyrjes janë përfshirë në periudhën e qirasë nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e mundur për tu shtyrë (ose për mos u përfunduar). Pagesat e qirasë që i përkasin periudhës së shtyrjes janë të përfshira ne llogaritjen e detyrimit për qiranë financiare.

Pagesat për qiranë janë të skontuara duke përdorur normën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, që është dhe rasti i qirave të Shoqërisë, përdoret norma e huamarrjes e cila është norma me të cilën Shoqëria do të duhej të merrte hua për të blerë aktive me vlerë sa vlera e aktivit me të drejtë përdorimi në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte apo kolateral të ngjashëm.
Për të përcaktuar normën e huamarrjes Shoqëria përdor normat e interesit të bankave të nivelit të dytë duke marrë në konsideratë afatin, shtetin, monedha, kolateralet dhe kushte të tjera

Pagesat për qiranë shpërndahen midis principalit dhe kostove financiare. Kostot financiare ngarkohen në pasqyrën fitimit ose humbjes gjatë periudhës së qirasë financiare në mënyrë që të krijohet një normë periodike interesi mbi balancën e mbetur të detyrimit pergjatë çdo periudhe.

Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtra të aktiveve dhe të gjitha qiratë për aktivet me vlerë të vogël njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Qiratë afatshkurtra janë qira me kohëzgjatje prej 12 muajsh ose më pak. Aktivet me vlerë të vogël janë aktive me vlerë 5,000 euro ose më pak. Shoqëria nuk ka qira me vlerë të vogël më 31.12.2019.

Për te optimizuar kostot përgjatë kohëzgjatjes së kontratës Shoqëria ndonjëherë krijon garanci në vlerën e mbetur për qiratë e pajisjeve. Shoqëria fillimisht llogarit dhe njeh shumën e pritshme për tu paguar nën garacinë e vlerës së mbetur si pjesë e detyrimit për qiranë. Zakonisht vlera e mbetur e pritshme në fillim të qirasë eshte e barabartë ose me e lartë se vlera e garancisë dhe Shoqëria nuk pret të ketë ndonjë pagesë shtesë. Në fund të çdo periudhe raportuese vlera e mbetur rishikohet dhe ndryshohet për të reflektar vlerën aktuale të mbetur në bazë të aktiveve të tjera të krahasueshme dhe parashikimeve për çmimet në të ardhmen

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(i) Detyrime të qirasë (vazhdim)

Qiratë klasifikohen si qira financiare kur termat e qirasë transferojnë në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet te qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operacionale.

Shoqëria aplikon SNRF 16 më 1 janar 2019 duke zbatuar modelin e qasjes se modifikuar retrospektive. Efekti kumulativ i aplikimit të SNRF 16 (nëse do të ketë) ,do të njihet si rregullim i balancës hapëse të fitimit të mbartur në 1 janar 2019, pa rideklarim të informacionit krahasues.

Nënqiraja dhe te ardhura nga qiraja

Shoqëria për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, nuk është përfshirë në aktivitete qiradhënie duke mos gjeneruar të ardhura nga qiraja si dhe nuk ka asnjë kontratë nënqiramarrje ose qiradhënieje.

(j) Dividendët

Dividentët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, janë të shpalosura në shënimet e ngjarjeve të mëvonshme.

(k) Provizionet për detyrime dhe shpenzime

Provizionet për detyrime dhe shpenzime janë detyrime jo-financiare ku koha dhe vlera janë të pasigurta. Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Provizioni matet me vlerën aktuale të shpenzimeve që duhen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provizion për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim i interesit në shpenzimet financiare.

(m) Të ardhurat nga shërbimet

Bazuar dhe në SNRF 15, Shoqëria njeh të ardhurat nga kontratat me klientët duke përdorur një model me pesë hapa për kontabilizimin e të ardhurave që rezultojnë nga kontratat me konsumatorët:

- identifikimi i kontratës me një klient;
- identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë;
- përcaktimi i çmimit të transaksionit;
- shpërndarja e çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë, dhe
- njohja e të ardhurave kur (ose si) njësia ekonomike përmbush një detyrim të performancës;

SNRF 15 kërkon që shoqëritë të përdorin gjykimin e tyre, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat domethënëse gjatë aplikimit të secilit prej hapave të modelit. Standardi gjithashtu përcakton njohjen e kostove fillestare të arritjes së një kontrate dhe kostove direkte për përmbushjen e kontratës. Për më tepër, standardi kërkon shënime të zgjeruara.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(l) Të ardhurat nga shërbimet (vazhdim)

Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në një shumë që reflekton shumën në të cilën njësia ekonomike pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një klient.

Kontratat e klientëve që shoqëria ka në përdorim janë kontrata afatshkurtra për një periudhë jo më shumë se 12 muaj. SNRF 15 nuk ka pasur impakt në Shoqëri pasi Shoqëria vepron nën cilësinë e Agjentit ku nuk aplikon ndryshimin e cmimit, i cili aplikohet nga Principali Maersk Line. Për më tepër, nuk ka rreziqe që shoqërojnë shërbimin pasi rreziku mbahet nga entiteti kryesor, Maersk Line.

Shoqëria është e angazhuar të veprojë si agjente e shoqërisë Maersk Line në fushën e transportit detar dhe të ardhurat njhen në momentin kur shërbimi i transportit kryhet.

Detyrimi i performancës së Shoqërisë në kontratat me klientët është ofrimi i shërbimeve të transportit sipas specifikimeve të kontrolluara nga Maresk Line të përcaktuara në kontratën me klientin. E ardhura njihet për vlerën e komisioneve të marra apo për t'u marrë nga Maresk Line.

Përgjithësisht Shoqëria nuk operon nëpërmjet parapagimeve me klientët. Dhe në rastet kur operohet nëpërmjet këtyre parapagimeve ato janë për periudha më të shkurtra se 30 ditë, si rrjedhojë Shoqëria nuk bën rregullime në llogaritë përkatëse.

Shitja e shërbimeve Shoqëria njeh të ardhura nga magazinimi dhe nga tarifat e trajtimit në terminal të kontenierëve, të ardhura nga transportimi brenda portit (ngarkim/shkarkim i kontenierëve) si dhe të ardhura nga energjia elektrike dhe ditëvonesat e kontenierëve në port.

Nëse Shoqëria ofron shërbime shtesë ndaj klientit pasi kontrolli mbi mallrat ka kaluar, të ardhurat nga shërbimet e tilla konsiderohen si një detyrim i veçantë i performancës dhe njihen gjatë kohës së dhënies së shërbimit. Klientët faturohen për shpenzimet e transportit si një detyrim i veçantë i performancës.

(m) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese. Ngarkesa e tatimit mbi të ardhurat përbën tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në të ardhura dhe shpenzime për vitin, përveç nëse kjo është njohur në kapitalin neto ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimbursohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat e tanishme dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuara përpara se të dorëzojnë deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç të ardhurave regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave sigurohet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit për humbjet tatimore që mbartin përpara dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon në asnjë llogari, as fitim të tatueshëm. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të miratuara ose të vendosura në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që mbarten në të ardhmen regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që diferenca e përkohshme të kthehet në të ardhmen dhe ekziston fitim i mjaftueshëm i ardhshëm i tatueshëm në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra janë kompensuar kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur aktivet dhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e shtyra kanë të bëjnë me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti autoritet tatimor në njësinë e njëjtë tatimore ose subjekte të ndryshme të tatueshme ku ka një qëllim për të shlyer gjendjet në baza neto.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

(n) Pozicionet e pasigurta tatimore

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojnë në vendosjen e taksave shtesë nëse këto pozicione do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratohen në mënyrë thelbësore deri në fund të periudhës raportuese, si dhe vendime te njohura nga gjykatat mbi çështje të tilla. Detyrimet për penalitetet, interesat dhe detyrimet tatimore të tjera nga të ardhurat, njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç interesave dhe gjobave, regjistrohen brenda tatimit mbi të ardhurat. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat në lidhje me interesat dhe gjobat, regjistrohen neto brenda shpenzimeve financiare dhe fitim/(humbjeve) të tjera, përkatësisht.

(o) Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në momentin më të hershëm se, (a) grumbullimin e kërkesave të arkëtueshme nga klientët ose (b) lëvrimin e mallrave ose shërbimeve tek klientët. TVSH-ja në blerje në përgjithësi mund të rikuperohet kundrejt TVSH-së së shitjeve pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe jepet si informacion shpjegues veçmas si një aktiv dhe pasiv. Aty ku është bërë një provizion për HPK të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore më ose pas 1 janar 2019)
Shoqëria miratoi SNRF 16 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive të adoptimit me datën e aplikimit fillestar të 1 janarit 2019,pa riparaqitur shifrat krahasuese dhe duke përdorur disa lehtësira të lejueshme nga standardi. Të gjitha aktivet me të drejtë përdorimi maten në vlerën e detyrimit të qirasë në momentin e miratimit (rregulluar për parapagime ose shpenzime të shtyra).
Në aplikimin e SNRF 16 për herë të parë, Shoqëria ka përdorur mjetet e mëposhtme praktike në tranzicion të lejuara nga standardi:

- duke u mbështetur në vlerësimet e mëparshme nëse qiratë janë të mëdha si një alternativë për të performuar një rishikim zhvlerësimi- nuk ka patur kontrata me vlerë të madhe më 1 janar 2019.
- llogaritjen e qirave operative me një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj nga 1 janari 2019 si qira afatshkurtra.
- duke përjashtuar kostot fillestare direkte për matjen e aktivit me të drejtë përdorimi në datën e aplikimit fillestar, dhe
- duke përdorur mbikëqyrje në përcaktimin e afatit të qirasë, kur kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Shoqëria ka zgjedhur të mos rivlerësojë nëse një kontratë është ose përmban një qira në datën e aplikimit filestar. Në vend të kësaj, për kontratat e lidhura përpara datës së tranzcionit Shoqëria është mbeshtetur mbi vlerësimin e bërë me aplikimin e SNK 17, *Qiratë* dhe KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban një "qira",

Norma mesatare rritëse e huamarrjes e aplikuar nga Shoqëria për detyrimet e qirasë më 1 janar 2019 ishte 3%.

4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

	1 janar 2019
Pagesat minimale të ardhëshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme* më 31 dhjetor 2018	3,932
- Pagesa të ardhëshme variabël të qirasë të bazuara në një indeks ose normë	-
- Efekti i skontimit në vlerë aktuale	(139)
Totali i detyrimit të qirasë i njohur më 1 janar 2019	**4,071**
Nga të cilat:	
Detyrime qiraje afatshkurtër	**2,066**
Detyrime qiraje afatgjatë	2,005

* Qiratë e paanullueshme përfshijnë vetëm ato që janë të anullueshme (a) nëse shfaqet një kusht i largët, (b) me aprovimin e qiradhënësit, (c) nëse qiramarrësi hyn në një kontratë të re për një aktiv të njejtë ose të ngjashëm ose (d) nëse ka pagesa nga qiramarrësi për këtë vlerë shtesë, që në fillim të qirasë dhe vazhdimësia e saj është siguri e arsyeshme.

Ndryshimi në politikat kontabël ndikoi zërat e pasqyrës së pozicionit financiar më 1 janar 2019 si më poshtë

	Impakti i zbatimit të SNRF 16
Rritje në aktivet me të drejtë përdorimi	4,132
Ulje në parapagime	(61)
Rritje në detyrimet e qirasë	4,071

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive për Shoqërinë nga 1 janari 2019, por nuk patën ndonjë ndikim material në Shoqëri.

- KIRFN 23 "Pasiguria mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat" (lëshuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (lëshuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkët" (lëshuar më 12 tetor 2017 dhe efektivë për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Përmirësime Vjetore të Ciklit të SNRF 2015-2017 - ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (lëshuar më 12 dhjetor 2017 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes" (lëshuar më 7 shkurt 2018 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

5. Standarde dhe interpretime të reja

Janë lëshuar disa standarde dhe interpretime të reja, të cilat janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020 të cilat Shoqëria nuk i ka miratuar më herët.
Ndryshimet e rëndësishme për Shoqërinë, për të cilat nuk pritet të ketë impakt në pasqyrat financiare janë si më poshtë:

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Ndërmarrjes Ndihmëse të tij ose Ndërmarrjes së Përbashkët Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (lëshuar në 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohen nga BSNK)..
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (lëshuar në 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshime në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (lëshuar më 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020). Kuadri Konceptual i rishikuar përfshin një kapitull të ri mbi matjen, udhëzim mbi raportimin e performancës financiare, udhëzime dhe përkufiyime të përmirësuara- në veçanti përkufizimi i një detyrimi dhe qartësime mbi çështje të caktuara, siç janë rolet e drejtimit, kujdesi dhe pasiguria në matje në raportimin financiar.

6. Aktive afatgjata materiale

	Kompjutera dhe pajisje zyre
Kosto	
Më 31 dhjetor 2018	**2,359**
Shtesa	1,687
Më 31 dhjetor 2019	4,046
Zhvlerësim i akumuluar	**(336)**
Zhvlerësimi për vitin	**(440)**
Më 31 dhjetor 2018	**(776)**
Zhvlerësimi për vitin	(333)
Më 31 dhjetor 2019	**(1,109)**
Vlera neto	
Më 31 dhjetor 2018	**1,605**
Më 31 dhjetor 2019	**2,959**

7. Aktive me të drejta përdorimi

Shoqëria merr me qira zyra dhe automjete. Kontratat e qirasë kanë afat të përcaktuar , por kanë mundësi zgjatje afati. Deri më 31 dhjetor 2018, kontratat e qirasë së aktiveve afatgjata materiale kanë qenë të klasifikuara si qira financiare ose qira operative.Shoqëria ka aplikuar për herë të parë në vitin financiar 31 dhjetor 2019 SNRF 16-Qiratë. SNRF 16 krijon një aktiv me të drejtë përdorimi, i cili amortizohet në mënyrë lineare deri në fund të kohëzgjatjes së afatit të qirasë.

	Aktive me të drejta përdorimi
1 janar 2019	**4,071**
Shtesa gjatë 2019	9,743
Shpenzimi i amortizimit	(3,932)
31 dhjetor 2019	**9,882**

8. Aktive afatgjata jomateriale

	Programe Kompjuterike
Kosto	
Më 31 dhjetor 2018	**1,557**
Shtesa	292
Më 31 dhjetor 2019	**1,849**
Amortizimi i akumuluar	-
Më 31 dhjetor 2018	**(389)**
Amortizimi për vitin	(584)
Më 31 dhjetor 2018	**(973)**
Vlera neto	
Më 31 dhjetor 2018	**1,168**
Më 31 dhjetor 2019	**876**

9. Llogari të arkëtueshme

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme nga palët e treta	81,993	137,420
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	18,861	51,323
Minus: Zbritja nga humbja e pritshme e kredisë (HPK)	(1,052)	(616)
Totali	**99,742**	**188,127**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura lidhen me veprimet me shoqëritë e grupit. Llogaritë e arkëtueshme nga palët e treta janë balancat neto të hapura me Maersk Line. Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes pasi në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor midis 30-120 ditë.

Shoqëria zbaton modelin e thjeshtuar të SNRF 9 për llogaritjen e humbjes të pritshme të llogarive të arkëtueshmeve, i cili parashikon pritshmërinë e humbjes gjatë të gjithë jetëgjatësisë në skemën e provizionimit të llogarive të arkëtueshme.

Lëvizjet në lidhje me provizionet për llogaritë e dyshimta janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Teprica më 1 janar	616	-
Shpenzimi i vitit	436	616
Teprica më 31 dhjetor	**1,052**	**616**

Normat e humbjeve dhe HPK-të për fundin e vitit 2019 janë paraqitur në tabelën më poshtë. Matrica e provizioneve bazohet në numrin e ditëve që një llogari e arkëtueshme është në vonesë, duke marre parasysh dhe arkëtimet e mëpasshme të kryera gjatë vitit 2020.

Ditë vonesat	*Humbje në %*	*Vlera kontabël bruto*	*HPK*
Jo në vonesë	0%	47,675	-
0 – 30 Ditë	0%	31,151	-
31-60 Ditë	0.1%	13,916	11
61-90 Ditë	2.0%	1,887	39
> 90 Ditë	16%	6,165	1,002
Totali		**100,794**	**1,052**

10. Aktive të tjera

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme të tjera	11,207	7,282
Të ardhura të akumuluara	-	4,661
Totali	**11,207**	**11,943**

11. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në arkë		
Në ALL	36	21
Në EUR	9	8
	45	29
Mjete monetare në bankë		
Në ALL	5,095	893
Në EUR	28,160	7,671
Në USD	23,051	29,714
	56,306	38,278
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	**56,351**	**38,307**

Shoqëria ka llogari rrjedhëse në Bankat Rezidente me vlerësim A-2 dhe B nga S&P. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të normës së interesit dhe analiza e ndjeshmërisë të aktiveve dhe detyrimeve financiare janë të përfshira në shënimin 21.

12. Kapitali i paguar

Numri dhe vlera e aksioneve të regjistruara deri më 31 dhjetor 2019:

Në dhjetor 2017 kapitali i regjistruar i Shoqërisë ishte 27,314 Lekë. Numri total i kuotave është 2, me vlerë prej 13,657 Lekë secila. Gjatë vitit 2018 është bëre kthimi i 13,644 Lekë ortakëve të Shoqërisë. Në fund të vitit 2018 kapitali i paguar ishte 13,670 Lekë. Përgjatë vitit të mbyllur 31 dhjetor 2019 nuk ka patur ndryshim të kapitalit aksionar.

Aksionerët

Tabela e mëposhtme tregon pozicionin dhe kontributin aktual të aksionerëve të Stella Mare më 31 dhjetor 2019:

Aksioneri	% Kapital	Kapitali i regjistruar në Lekë
Balfin Shpk	50%	6,835
Milsped Doo Beograd	50%	6,835
Totali	**100%**	**13,670**

13. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj palëve të treta	89,399	168,613
Të pagueshme ndaj Maersk Line	620	464
Totali	**90,019**	**169,077**

14. Detyrime të tjera

Të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjoba dhe detyrime	3,758	3,758
Tatimi i paguesheëm mbi fitimin	9,743	8,607
TVSH e pagueshme	1,752	3,974
Detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	572	558
Tatimi në burim i paguesheëm	43	64
Shpenzimet e përllogaritura	(767)	(1,596)
Garanci	(309)	-
Totali	**14,792**	**15,365**

Garancitë lidhen me shumat e mbajtura nga konsumatorët për të mbuluar humbjet e papritura për kontenierët.

15. Detyrime qiraje

Shoqëria merr me qira ndërtesa dhe automjete. Kontratat e qirasë kanë afat të përcaktuar , por kanë mundësi zgjatjeje afati.

Deri më 31 dhjetor 2018, kontratat e qirasë së aktiveve afatgjata materiale kanë qenë të klasifikuara si qira financiare ose qira operative. Duke filluar nga 1 janar 2019, qiratë janë njohur si aktive me të drejta përdorimi dhe është njohur gjithashtu një detyrim qiraje koresponduese, nga data që aktivi merret në përdorim nga Shoqëria.

Më poshtë jepet paraqitja e detyrimit të qirasë për vitin 2019:

	Detyrime qiraje
1 janar 2019	**4,071**
Shtesa gjatë 2019	9,743
Pagesë qiraje	(4,047)
Shpenzime interesi	325
Fitim/Humbje nga kursi i këmbimit-	(225)
31 dhjetor 2019	**9,867**

Shoqëria ka njohur detyrime qiraje si më poshtë:

	31.12.2019	01.01.2019
Detyrime qiraje afatshkurtra	3,509	-
Detyrime qiraje afatgjata	6,358	-
Total	**9,867**	-

16. Të ardhura nga shërbimi

Të ardhurat e njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga Transportimi brenda portit, Energjia Elektrike dhe ditëvonesat e kontenierëve	124,980	73,997
Komisione të agjentit	48,035	49,598
Të ardhura nga tarifat e trajtimit në terminal	16,000	11,254
Të ardhura nga Magazinimi	10,021	39,471
Të ardhura të tjera	9,160	6,482
Totali	**208,196**	**180,802**

Komisioni i Agjentit përfaqëson të ardhurat sipas Marrëveshjes Agjent-Principal midis Shoqërisë dhe Maersk Line A/S.

Të ardhurat nga tarifat dhe magazinimi për trajtimin e terminalit përfaqësojnë të ardhura nga ngarkimi dhe shkarkimi i kontenierëve në port.

Të ardhurat e tjera perfaqësojnë të ardhura nga transporti tokësor dhe shërbime shtesë në port.

17. Shpenzime transporti dhe energjisë elektrike

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzimet e transportit dhe energjisë elektrike	103,124	84,314
Totali	**103,124**	**84,314**

18. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit si dhe shpenzimet e lidhura me to për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Paga	19,884	18,965
Sigurime shoqërore dhe kontribute shëndetësore	2,388	2,091
Shpenzime të tjera	135	183
Totali	**22,407**	**21,239**

19. Shpenzime të përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Konsulencë financiare	3,174	2,550
Humbje nga kursi i këmbimit	2,599	3,530
Tarifat bankare	1,685	1,724
Shpenzimet e sigurimit	1,435	315
Dieta	902	1,100
Shpenzime të tjera	856	1,687
Shpenzimet e telekomunikacionit	765	616
Fikse	722	932
Shërbimet e IT	546	371
Shpenzimet ligjore	455	69
Utilitete	424	262
Shpenzimet e karburantit	415	399
Mirëmbajtja e zyrës	376	88
Tarifat doganore	351	455
Shpenzime auditimi	307	419
Shpenzimet e marketingut	213	153
Taksat lokale	107	108
Shpenzimet e përfaqësimit	33	3,929
Qiraja operacionale	4	22
Qira	-	3,732
Totali	**15,369**	**22,461**

20. Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të fitimin në Shqipëri me një normë të tatimit mbi fitimin prej 15% për vitin 2019 dhe 2018. Formularët e deklaratave tatimore dorëzohen çdo vit. Të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore konsiderohen si vetë-deklarim derisa ato të shqyrtohen dhe vlerësohen nga autoritetet tatimore. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë subjekt i interpretimit nga autoritetet tatimore.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi i vitit para tatimit	**62,446**	**51,918**
Shpenzimet e pa zbritshme	2,178	7,467
Të ardhura të përllogaritura	-	16,365
Shpenzimet e përllogaritura	767	14,769
Shpenzime të shtyra	-	(1,596)
Fitimi para tatimit	**65,390**	**74,154**
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për vitin (15%)	(9,809)	(11,123)
Shpenzim i tatim fitimit të shtyrë	-	2,455
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm/(i pagueshëm) më 1 janar	2,271	62
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	9,202	10,877
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm me 31 dhjetor	**1,664**	**2,271**

20. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Të ardhurat e deklaruara në sistemin e Autoritetit të Tatimeve për vitin që përfundon më 2019 dhe 2018 janë të ndryshme nga ato të kontabilitetit sepse Shoqëria si agjent tatimor ka përfshirë në deklaratën e saj edhe faturat e shitjes në emër të Maersk Line A/S. Këto shitje nuk janë të ardhura për Shoqërinë dhe rrjedhimisht nuk janë pjesë e të ardhurave sipas kontabilitetit në tabelën e mësipërme. Më poshtë paraqitet një barazim ndërmjet të ardhurave sipas deklaratave dhe të ardhurave kontabël:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Per vitin e mbyllur më me 31 dhjetor 2018
Të ardhurat e faturuara si agjent		
Të ardhurat e raportuara në librat e TVSh-së	1,532,337	1,611,348
Faturat e transportit në emër të Principalit	(968,567)	(816,103)
Faturat per sherbimet ne emer te Principalit	-	(323,985)
Shitjet e tjera në emër të Principalit	(352,380)	(291,941)
Faturat autofatura	(3,194)	(3,178)
Ndikimi i të ardhurave të përllogaritura		
Të hyrat e përllogaritura për 2018, të faturuara në 2019	-	4,661
Të hyrat e përllogaritura për 2019, të faturuara në 2020	-	-
Të ardhurat totale të raportuara në pasqyrën e të ardhurave	**208,196**	**180,802**

Rakordimi midis normës efektive të tatimit dhe normës së përdorur për llogaritjen e fitimit për qëllime fiskale është paraqitur më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019		Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2018	
	Norma efektive		Norma efektive	
Fitimi para tatimit		62,446		51,918
Shpenzimi i taksës së shtyrë	0%	-	5%	(2,455)
Taksa me normën 15% (2018: 15%)	15.00%	9,367	15.00%	7,788
Efekti i shpenzimeve të panjohura	0.66%	442	2.16%	1,120 (239.40)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshire shpenzimin e shtyrë	**0%**	**-**	**21.42%**	**11,123**
Shpenzimi i taksës së shtyrë	**15.66%**	**9,809**	**-5%**	**(2,455)**
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin	**15.66%**	**9,809**	**16.70%**	**8,668**

21. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit, dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto shënime të pasqyrave financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

21. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

a. Rreziku i kredisë

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Natyra e sektorit të biznesit nuk lejon përqëndrim të lartë të rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme meqe Shoqëria i mban dokumentat ligjore të kerkuar për plotesimin e shërbimit. Shoqëria nuk lejon lëshimin e dokumentave pa marrë prova për pagesën dhe në raste që i lëshon, vlëreson gjendjen kreditore të klientit.

Lejimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta është i prezantuar në një shumë që konsiderohet t nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në arkëtimin e balancave të llogarive të arkëtueshme.

Entiteti përdor shërbimet e palëve të treta për të siguruar llogaritë e arkëtueshme dhe mbrojtur pozicionin në rast mos-arkëtimi.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	56,351	38,307
Llogari të arkëtueshme	99,742	188,127
Aktive të tjera	11,207	11,943
Totali	**167,300**	**238,377**

Llogaritë e arkëtueshme

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Megjithatë, drejtimi gjithashtu konsideron faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në rrezikun e kredisë të bazës së saj të klientëve, duke përfshirë rrezikun e dështimit të industrisë.

Drejtimi ka vendosur një politikë kredie sipas të cilës çdo klient i ri është analizuar individualisht për aftësinë paguese para se të ofrohen kushtet standarte të pagesës dhe dorëzimit. Shqyrtimi i Shoqërisë përfshin vlerësimet e jashtme, nëse ato janë në dispozicion, pasqyrat financiare, informacionet e industrisë dhe në disa raste referencat bankare. Shoqëria monitoron rregullisht situatën financiare të klientëve të saj.

Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë nga të arkëtueshmet tregtare duke përcaktuar afatet e pagesës për secilën kategori të klientëve dhe shpërndarësit trajtohen me parapagim dhe duke ofruar garanci bankare në emër të Shoqërisë, për qëllime kredie gjatë sezonit të lartë. Klientët e drejtpërdrejtë menaxhohen përmes marrëveshjeve të cilat kanë terma fikse për sa i përket shumës së kredisë dhe planeve të ripagimit .

Vlerësimi i humbjes së pritshme të kredisë

Shoqëria ka zgjedhur të matë humbjet e zbritshme për të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshmet nga palët e lidhura në vlerën e humbjeve të pritshme të kredisë përgjatë jetës, duke përdorur matricën e provizionit në të cilën humbjet e pritshme llogariten duke u bazuar në normat e humbjes së pritshme për të arkëtueshmet në bazë të maturitetit të tyre.

Normat e humbjes së pritshme bazohen në natyrën e pagesave të shitjes dhe në humbjet e pritshme historike të ndodhura gjatë kësaj periudhe. Normat historike të humbjes rregullohen në mënyrë që të pasqyojë informacionin aktual dhe të ardhshëm mbi faktorët makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer detyrimet. Normat e humbjes llogariten veçmas për ekspozime në segmente të ndryshme bazuar në karakteristikat e rrezikut të kredisë.

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Shoqëria aplikon një bazë humbje 12-mujore dhe reflekton maturitetet e shkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit të mjete monetare dhe ekuivalente të tyre. Me 31 dhjetor 2019, për shkak të ekspozimit afatshkurtër, Shoqëria nuk ka njohur zhvleresim në pasqyrat financiare

21. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm.

Aktivet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2019, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
Aktive financiare				
Llogari të arkëtueshme	94,579	5,163	-	**99,742**
Aktive të tjera	-	11,207	-	**11,207**
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	56,351	-	-	**56,351**
Totali i aktiveve financiare	150,930	16,370	-	**167,300**
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	90,019	-	-	**90,019**
Detyrime të tjera	15,868	-	(309)	**15,559**
Detyrimi i qirasë	3,509		6,358	9,867
Totali i detyrimeve financiare	109,396	-	6,049	115,449
Hendeku i likuiditetit	41,534	16,370	(6,049)	51,855
Hendeku kumulativ	41,534	57,904	51,855	-

Aktivet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2018, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
Aktive financiare				
Llogari të arkëtueshme	167,588	20,539	-	**188,127**
Aktive të tjera	-	11,943	-	**11,943**
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	38,307	-	-	**38,307**
Totali i aktiveve financiare	205,895	32,482	-	**238,377**
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	167,420	1,657	-	**169,077**
Detyrime të tjera	9,773	-	5,592	15,365
Totali i detyrimeve financiare	177,193	1,657	5,592	184,442
Hendeku i likuiditetit	28,702	30,825	(5,592)	53,935
Hendeku kumulativ	28,702	59,527	53,935	-

21. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit mbi menaxhimin e rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria nuk përballet me rrezikun e normës së interesit pasi nuk ka huamarrje në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Shoqëria ka gjendje të konsiderueshme në Euro dhe Dollar nga klientët e saj dhe kundrejt furnitorëve të saj, fakt i cili e mbron Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

	Euro	USD	Lek	Vlera kontabël
Llogari të arkëtueshme	62,152	37,590	-	99,742
Aktive të tjera	563	-	10,644	11,207
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	28,169	23,051	5,131	56,351
Totali i aktiveve monetare	**90,884**	**60,641**	**15,775**	**167,300**
Llogari të pagueshme	61,409	28,012	598	90,023
Detyrime të tjera	-	-	15,559	15,559
Detyrimi i qirasë	9,867	-	-	9,867
Totali i detyrimeve monetare	**71,276**	**28,012**	**16,157**	**115,445**
Ekspozimi neto	**19,608**	**32,629**	**-382**	**51,855**

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

	Euro	USD	Lek	Vlera kontabël
Llogari të arkëtueshme	127,139	60,396	592	188,127
Aktive të tjera	(3,594)	4,660	10,877	11,943
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	7,679	29,714	914	38,307
Totali i aktiveve monetare	**131,224**	**94,770**	**12,383**	**238,377**
Llogari të pagueshme	124,051	44,422	604	169,077
Detyrime të tjera	-	-	15,365	15,365
Totali i detyrimeve monetare	124,051	44,422	15,969	184,442
Ekspozimi neto	7,173	50,348	-3,586	53,935

21. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë

Me anën e menaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e vazhdueshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2019 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e normave të interesit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhave të tjera nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Drejtimi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit ndaj totalit të kapitalit, duke përjashtuar aksionet e preferuara të parevokueshme dhe interesat e pakicës. Drejtimi gjithashtu monitoron nivelin e dividendëve ndaj ortakut. Gjatë këtij viti nuk ka patur ndryshime në mënyrën e menaxhimit të kapitalit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

22. Angazhime dhe pasiguri

Pasiguria e pretendimeve ligjore: Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Gjatë vitit 2019 është bërë ndjekja e çështjes me autoritetet tatimore, e cila ka rezultuar në nëntor te vitit 2018. Çështja i referohet kësteve të Tatim Fitimit. Nga administrata tatimore është vendosur gjobë për mospagim të kësteve të Tatim Fitimit. Çështja është apeluar në gjykatën administrative të shkallës së parë.

23. Transaksione me palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqëritë mëmë, shoqëritë simotra si dhe me drejtuesit e saj.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, shpërblimi i drejtimit në vlerën 4,600 mijë lekë (2018: 2,300 mijë lekë) është i përfshirë në shpenzimet e personelit.

Gjatë vitit Shoqëria kishte këto transaksione me palët e lidhura:

	2019	2018
Blerje nga:		
Acrem SHPK	5	54
Balfin SHPK	326	184
Milsped Albania	3,082	3,651
Neptun SHPK	317	127
Kid Zone SHPK	26	-
Spar Albania	-	25
Elektroservice	84	10
Milsped doo	3,476	3,021
Shitje ndaj:		
Milsped Albania	563	385
Neptun SHPK	1,110	1,122
Albchrome SHPK	35,893	36,172
Ferronikel LLc	98,590	33,066
Milsped D.o.o	3,792	1,424

23. Transaksione me palët e lidhura (vazhdim)

Në çdo datë raportimi, në pasqyrën e pozicionit financiar janë përfshirë vlerat e mëposhtme për palët e lidhura:

	31.12.2019	31.12.2018
Të arkëtueshme nga:		
Milsped Albania	74	167
Neptun SHPK	-	397
Albchrome SHPK	1,231	5,151
Ferronikel LLc	14,349	44,665
Milsped doo	3,207	943
Totali	**18,861**	**51,323**
Të pagueshme ndaj:		
Balfin SHPK	131	-
Milsped Albania	477	175
Kid Zone SHPK	12	-
Totali	**620**	**175**

24. Ngjarje pas periudhës raportuese

Në fund të vitit 2019 u shfaq për herë të parë në Kinë lajmi në lidhje me COVID-19 (Coronavirus). Situata i referohej një numri të kufizuar të rasteve të një virusi të panjohur të raportuar në Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Në muajt e parë të vitit 2020 virusi ishte përhapur globalisht dhe ndikimi i tij negativ kishte filluar të ndihej. Drejtimi vlerëson që kjo situatë nuk përbën një ngjarje rregulluese pas datës së raportimit. Situata është ende në zhvillim në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, por deri më tani nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm në operacionet e Shoqërisë, megjithatë efektet e ardhshme nuk mund të parashikohen. Drejtimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të zbutur çdo efekt.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që do të kërkojnë rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare.

25. Politika kontabël për qiratë përpara 1 janar 2019

Politikat kontabël të aplikueshme për periudhën krahasuese të mbyllur më 31 dhjetor 2018 të cilat janë ndryshuar nga SNRF 16, *Qiratë*, janë si vijon.

Qiratë operative. Kur Shoqëria është një qiramarrës në një qira e cila nuk transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet rastësore nga qiramarrësi te Shoqëria, totali i pagesave të qirasë njihen në fitim ose humbje të vitit në baza lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Afati i qirasë është një periudhë e paanullueshme për të cilën qiramarrësi ka hyrë në një kontratë për të marrë me qira aktivin duke përfshirë edhe kushtet nga të cilat qiramarrësi ka opsionin të vazhdojë qiranë, me ose pa pagesa të mëtejshme, kur ka siguri të arsyeshme në fillim të qirasë se qiramarrësi do ta ushtrojë atë të drejtë.

Kur aktivet janë dhënë si qira operative, pagesat e arkëtueshme të qirasë njihen si e ardhur nga qiraja në baza lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë.

Detyrimet e qirasë financiare. Kur Shoqëria është një qiramarrës në një qira e cila transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet rastësore nga qiramarrësi te Shoqëria, aktivet e marra me qira kapitalizohen në aktive afatgjata materiale në fillim të qirasë në vlerën më të ulët mes vlerës së drejtë të aktivit me qira dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Çdo pagesë qiraje qëndron midis detyrimit dhe tarifave financiare në mënyrë për të arritur një normë konstante për balancën e mbetur. Detyrimet përkatëse të qirasë, neto nga tarifat e ardhëshme financiare, përfshihen në huamarrje. Shpenzimi i interesave njihet në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Aktivet nga qiraja financiare amortizohen me jetën e tyre të dobishme ose me afatin e qirasë, nëse Shoqëria nuk ka siguri të arsyeshme se do të ketë pronësi në fund të afatit të qirasë.